

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	A mund të heqë dorë Turqia nga energjia ruse? – Vizion Plus
ADRESA	https://www.vizionplus.tv/a-mund-te-heqe-dore-turqia-nga-energjia-ruse/
BURIMI	vizionplus.tv
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	9 shtator 2026, 09:21:40 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	5 tetor 2025, 19:21:05 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	af67c33fd5491b3fe97b342b99de96bdd655d9e09bf00575578248d277234f67
TEKSTI	7055f2153603ad8b4481375117b6f43684197475c2a1021240b4f2d09aae3114
PAMJA	4ce285f529cad93c6ec6c398044bc1b7132c57e8058f04d5de953356c196a008

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	00562b155760b091c75720f8eeb40f594a5e82ddc9cff1dea084092b1a1f0f21
E MËPARSHMJA	a616f5a919c1e03cc08fb4ad1815e29225d90d39a3074ed8ea2f8e31b93c9e06
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/00562b155760b091c75720f8eeb40f594a5e82ddc9cff1dea084092b1a1f0f21>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Deri më tani, Turqia nuk ka reaguar pas deklaratave të Donald Trumpit apo kërkesës së G7-ës. Varësia e saj energjetike është pika më e ndjeshme e vendit në Bosfor. Turqia është jashtëzakonisht e varur nga Rusia për furnizimet e saj me energji.

Fakte dhe shifra mbi varësinë turke

Sipas të dhënave nga Autoriteti Rregullator i Tregjeve të Energjisë Turke (EPDK), 66 përqind e importeve dhe produkteve turke të naftës erdhën nga Rusia vitin e kaluar. Sipas ekspertit kryesor të energjisë Necdet Pamir, shifra ishte më shumë se 68 përqind një vit më parë se 2024-n, kurse deri në fund të vitit 2022, ajo ishte në 41 përqind.

Shifrat e larta të importit janë një pasojë e drejtpërdrejtë e luftës së agresionit të Rusisë kundër Ukrainës: Turqia po përfiton nga fakti që Rusia është nën presion për shkak të sanksioneve të BE-së dhe po ofron përkohësisht naftën e saj deri në 15 përqind nën çmimet e tregut ndërkombëtar. Një ndalim importi jo vetëm që do të rrezikonte sigurinë e furnizimit të Turqisë, por do të eliminonte edhe këtë avantazh të qartë çmimi. Edhe 41 përqind të importeve të saj të gazit natyror Ankaraja i mori nga Rusia në vitin 2024. Gazi rus i dorëzohet Turqisë kryesisht përmes tubacioneve Blue Stream (Mavi Akim) dhe Turk Stream (Türk Akim).

Refuzimi i Moskës dhe strategjia e Turqisë

Menjëherë pas takimit të Trump me Erdoganin, Kremlini njoftoi përmes zëdhënësit, Dmitry Peskov, se tubacionet e gazit për në Turqi vazhdonin të

5 Pas shkarkimit të Ristanit, jep dorëheqjen sekretari i përgjithshëm...

NEWSLETTER

Përmbledhja e ditës në e-mail

Abonohu

funksiononin me “kapacitet të plotë”. Nuk do të kishte ndërprerje për sa kohë që rrjedha e gazit ishte “e dobishme” për Turqinë. Peskov e qartësoi edhe qëndrimin e Moskës: “Turqia është një shtet sovran që merr vendimet e veta në lidhje me bashkëpunimin me ne”.

Ekspertët nuk presin që Turqia të ndalojë importet e energjisë nga Rusia në vitet e ardhshme. Në vend të kësaj, Ankara po ndjek një strategji të qetë: diversifikimin. Kompania shtetërore BOTAS nënshkroi dy kontrata afatgjata gjatë vizitës së fundit të Erdoganit në Shtetet e Bashkuara për të zgjeruar furnizimin e saj me gaz natyror: një marrëveshje me kompaninë amerikane Mercuria për të furnizuar një total prej 70 miliardë metrash kub gaz natyror të lëngshëm (LNG) për 20 vjet duke filluar nga viti 2026; Për më tepër, u njoftua një marrëveshje paraprake me Woodside Energy për 5.8 miliardë metra kub LNG.

Kadri Tastan, ekspert për Turqinë në Fondin Gjerman Marshall me seli në SHBA, vëren se qeveria turke ka bërë vërtet përpjekje të mëdha vitet e fundit për të diversifikuar burimet dhe për të siguruar sigurinë e saj energjetike. Në të njëjtën kohë, ajo po promovon gjithashtu energjitë vendase dhe, në veçanti, energjitë e rinovueshme. Sipas tij, marrëveshjet e reja me SHBA-në përmbajnë edhe një aspekt strategjik përveç diversifikimit. Marrëdhëniet politike me SHBA-në kanë qenë të tendosura vitet e fundit, kujton Tastan. Përveç Shteteve të Bashkuara, Turqia ka nënshkruar kontrata për gaz natyror të lëngshëm edhe me Egjiptin, Algjerinë, Katarin dhe Nigerinë në vitet e fundit.

Ankara: E varur nga Moska për energjinë bërthamore dhe linjtin

Turqia po ashtu është shumë e varur nga Rusia edhe në lidhje me burime të tjera energjie. Në vitin 2022, vendi mbuloi 43 përqind të nevojave për linjit nga importet ruse. Përveç kësaj, termocentrali i parë bërthamor, Akkuyu, po ndërtohet në Turqinë jugore nga kompania shtetërore ruse Rosatom. Vënia në punë e centralit bërthamor është shtyrë vazhdimisht, kjo sepse përfundimi i tij po vonon për shkak të sanksioneve kundër Rosisë. Sipas Ministrit Turk të Energjisë Alparslan Bayraktar, ai është planifikuar të fillojë vitin e ardhshëm. Por nuk ka gjasa që termocentrali të përfundojë plotësisht deri në vitin 2028.

Kështu, Turqia ka të ngjarë të vazhdojë aktin kompleks të balancimit në lidhje me furnizimin e saj me energji edhe në të ardhmen: e ndodhur mes Perëndimit, që kërkon sanksione kundër Moskës, dhe Rosisë, furnizuesit të saj më të rëndësishëm të energjisë për momentin. Trump ndjek një kurs të ri lidhur me luftën e Ukrainës./dw

#Gaz #Rusi #Turqi



Xhuljana Zhuleku

Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

Më shumë opinione



ff OPINION

Cfarë do të thotë



ff OPINION

Dronët ukrainas që po



ff OPINION

“Lokalet” në Kosovë

kapja e maduros per...

Xhuljana
Zhuleku

6
Jan

godasin arken e iurt...

Xhuljana
Zhuleku

1
Dhj

ao te sjeiin narysni...

Xhuljana
Zhuleku

11
Tet



Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

LIVE



Lajme

Politikë
Bota
Vendi
Kronikë
Lifestyle

Programe

Programe
Seriale
Guida TV
Video
Ekipi i Vizion Plus

Rrjeti

Rreth nesh
Karriera
Kontakt
Reklamo me ne
Dërgo lajmin tënd

Ligjore

Kushtet e përdorimit
Privatësia
Cookies
Politika editoriale

© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara

vizionplus.tv

Kthehu lart ↑

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.